



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:026077

Datë: 28.12.2018

Numri i dokumentit: 00198435

P.nr.830/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Kaltrina Halilaj - praktikante pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.S., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 382 par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë **28.12.2018**, në prezencën e Prokurori të shtetit Dëshire Jusaj, të dëmtuarit A.H., të akuzuarit si dhe mbrojtësit të tij av.I.S. nga Prishtina, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, dhe në të njëjtën ditë e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

I.S., nga i ati D., e ëma R., e gjinisë K., data e lindjes..., Komuna e Gjakovës ku edhe tani banon, por ka vendqëndrim edhe në Gjermani në Falkenks, i martuar, baba i tre fëmijëve, punon në Gjermani, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, numër të personal....

Ë S H T Ë F A J T O R

I. Se me datën 17.08.2017, rreth orës 01:00, në rrugën e fshatit K.-R., Komuna e Gjakovës, duke drejtuar automjetin e tij të tipit “Mercedes” CDI me targa regjistrimit Gjerman ..., ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e të dëmtuarit A.H., Komuna e Gjakovës, në atë mënyrë që ka drejtuar automjetin në kundërshtim me nenin 48, 53, 55 dhe nenin 210 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, edhe pse i vetëdijshëm se me një veprim të tillë do vije deri te pasoja e ndaluar lehtas e ka marrë se nuk do vijë apo në momentin e duhur do ti shmanget, ashtu që me të arritur afër restorantit “Te P.”, nga pakujdesia gjatë lëvizjes nga mos përshtatja e shpejtësisë së lëvizjes në raport me kushtet dhe rrethanat e rrugës dhe mos drejtimin e automjetit nëpër shiritin e duhur të tij qarkullues të rrugës ka kaluar në shiritin e majtë dhe skaje rruge në anën e majtë me pasqyrën e majtë me pasqyrën e majtë të automjetit ka goditur këmbësorin në këmbën e djathtë duke shkaktuar aksident komunikacioni, me çka të njëjtit i shkaktonte lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr. N.H. të dt. 05.10.2017.

Me këto veprime ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

II. Me datë, kohë dhe vend e përshkruar si në dispozitivin e I-rë të Aktakuzës, nga pakujdesia gjatë lëvizjes së automjetit të tij “Mercedes” CDI me targa regjistrimit Gjerman ..., nga mos përshtatja e shpejtësie së lëvizjes në raport me kushtet dhe rrethanat e rrugës dhe mos drejtimin e automjetit nëpër shiritin e duhur të tij qarkullues të rrugës pasi ka goditur në këmbën e djathtë këmbësorin A.H. ka vepruar në kundërshtim me nenin 210 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, lëvizë rrugës dhe nuk ndalet për të shikuar si vozitës i automjetit me të cilin shkakton aksident komunikacioni dhe nuk i ofron ndihmën e të dëmtuarit A.H..

Me këto veprime ka kryer veprën penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 382 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 41, 43, par.1 nënpar. 1.3, 46, 73, 74 dhe neneve 378 par.6 lidhur me par.1, 382 par.1 të KPRK-së, të akuzuarit ia shqipton dënimet si në vijim :

- **Për veprën penale nën.I** të dispozitivit **Dënimin me Gjobë** në shumë prej 500 (pesëqind) Euro.
- **Për veprën penale nën.II** të dispozitivit **Dënimin me Gjobë** në shumë prej 200 (dyqind) Euro

Konform nenit 80 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit ia shqipton:

DËNIMIN UNIK ME GJOBË në shumë prej 700 (gjashtëqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi atëherë dënimi me gjobë në shumë, të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 35 (tridhjetepesë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg do të llogaritet nga 20 (njëzetë) Euro.

I dëmtuari: A.(H.)H., Komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari B.S. që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 40.88 Euro, për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 20 Euro, shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 Euro të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.1330/17, të datës 27.11.2017, kundër të akuzuarit B.S.K. nga Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale: rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 382 par. 1 të KPRK-së dhe të njëjtës ia ka bashkangjitur kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do të shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri i ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë. Gjykata duke vepruar sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm ka marr Aktgjykimin P.nr.830/17 të datës 11.06.2018 me të cilin ka pranuar kërkesën për dhënien e Urdhrit ndëshkimor me numër PP.nr.1330/17 të datës 27.11.2017 dhe të akuzuarit B.S.i ka shqiptuar dënimin unik me gjobë në lartësi prej 600 (gjashtëqind) Euro të cilin dënim ka qenë i obliguar që ta paguajë në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, mirëpo mbrojtësi i të akuzuarit I.S., av. I.S. në afatin ligjor ka parashtruar kundërshtim ndaj Aktgjykimit P.nr.830/17 të datës 11.06.2018 për shkak të së cilës edhe gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit B.S. andaj ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari B.S. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: e pranoj fajësinë për veprat penale për të cilat ngarkohem dhe shtoj se jam penduar për këtë veprim dhe i kërkoj falje publikisht këtu të dëmtuarit A.H., nuk kam dashur që të vije deri të kjo, ka qenë pakujdesi dhe është hera e parë që më ka ndodh kështu rasti, prandaj i premtoj gjykatës se në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe nuk do të përsëris veprime të kështilla.

Në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit, Dëshire Jusaj ka deklaruar se: gjendja faktike e përshkruar si në diapozitivat e aktakuzës u argumentua në këtë shqyrtim gjyqësor, me vetë faktin e pranimit të fajësisë në mënyrë të vullnetshme dhe pa presion nga ana e të akuzuarit I.S., i cili pranim ka mbështetje në prova dhe në shkresat e lëndës e nga të cilat vërtetohet edhe përgjegjësinë penale për veprat e kryera si në aktakuzë kërkoj nga gjykata që i akuzuar të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Në fjalën përfundimtare i dëmtuari A.H. ka deklaruar se : parashtror kërkesë pasurore juridike ndaj të akuzuarit dhe kërkoj nga gjykata që i njëjti të dënohet për veprat penale.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit I.S., av.I.S. ka deklaruar se: në kuptim të rrethanave lehtësuese i propozoj gjykatës që gjatë procedimit të kësaj çështje penale juridike, ti shqiptojë një dënim të kushtëzuar ose vërejtje gjyqësore për shkak se nga gjithë shkresat e lëndës ky rast ka ndodhur nga një pakujdesi, dhe deri tek veprat penale nuk kanë ardhur nga një veprim i paramenduar nga ana e të akuzuarit, andaj i propozoj gjykatës që ti merr parasysh rrethanat lehtësuese nga neni 75 dhe 76 të KPP-së, dhe t'i shqiptojë një dënim më të butë ngase nga shkresat e lëndës nuk vërejtëm se për të mbrojturin tim ekziston ndonjë rrethanë rënduese nga të cilat edhe mund ti shqiptohet një dënim më i rëndë.

Në fjalën përfundimtare të të akuzuarit I.S., ka deklaruar se : në tërësi pajtohet me theksimet e mbrojtësit të tij av. I.S.

Në shqyrtimin gjyqësor gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike:

I. Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B.S. me datën 17.08.2017, rreth orës 01:00, në rrugën e fshatit K.-R., Komuna e Gjakovës, duke drejtuar automjetin e tij të tipit “Mercedes” CDI me targa regjistrimit Gjerman, ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e të dëmtuarit A.H., Komuna e Gjakovës, në atë mënyrë që ka drejtuar automjetin në kundërshtim me nenin 48, 53, 55 dhe nenin 210 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, edhe pse i vetëdijshëm se me një veprim të tillë do vije deri te pasoja e ndaluar lehtas e ka marrë se nuk do vijë apo në momentin e duhur do ti shmanget, ashtu që me të arritur afër restorantit “Te P.”, nga pakujdesia gjatë lëvizjes nga mos përshtatja e shpejtësisë së lëvizjes në raport me kushtet dhe rrethanat e rrugës dhe mos drejtimin e automjetit nëpër shiritin e duhur të tij qarkullues të rrugës ka kaluar në shiritin e majtë dhe skaje rruge në anën e majtë me pasqyrën e majtë me pasqyrën e majtë të automjetit ka goditur këmbësorin në këmbën e djathtë duke shkaktuar aksident komunikacioni, me çka të njëjtit i shkakton lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr. N.H. të dt. 05.10.2017.

II. Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B.S. me datë, kohë dhe vend e përshkruar si në dispozitivin e I-rë të Aktgjykimit, nga pakujdesia gjatë lëvizjes së automjetit të tij “Mercedes” CDI me targa regjistrimit Gjerman, nga mos përshtatja e shpejtësisë së lëvizjes në raport me kushtet dhe rrethanat e rrugës dhe mos drejtimin e automjetit nëpër shiritin e duhur të tij qarkullues të rrugës pasi ka goditur në këmbën e djathtë këmbësorin A.H. ka vepruar në kundërshtim me nenin 210 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, lëvizë rrugës dhe nuk ndalet për të shikuar si vozitës i automjetit me të cilin shkakton aksident komunikacioni dhe nuk i ofron ndihmën e të dëmtuarit A.H..

Gjykata gjendjet e këtyra faktike i ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurorja e Shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit në dispozitivin I të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale: rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa në veprimet e të akuzuarit në dispozitivin II të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 382 par.1 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprat penale dhe ta gjykojë në bazë të ligjit e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se është baba i katër fëmijëve, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin gjyqësor, pendimin e tij duke i kërkuar faljen publike të

dëmtuarit dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, si dhe faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi unik me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 lidhur me par.1 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.830/17, me datë 28.12.2018

Procesmbajtësja,
Kaltrina Halilaj

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.